



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria e Arsimit  
Nr.04/136  
Më: 23.04.2024

Duke u bazuar në UA –MASHTI nr.02/2016 për Aktivitetet Jashtëshkollore i dt.12/01/2016, Procesverbalin e mbledhjes nga KDSH të shkollës nr.prot.04/1754 dt.04.04.2024, dhe Ofertën me nr prot.04/1763 i dt.16.04.2024 lidhur me organizimin e ekskursionit për maturantë në SHMLMj. “Hysni Zajmi” në Gjakovë, për bartjen e nxënësve në Republikën e Shqipërisë me qëndrim në Durrës. Nga Durrësi vizitohen: Vlora, Kruja, Tirana, Berati dhe Durrësi. Ekskursioni zgjatë 4 fjetje pansioni i plotë prej datës 14/05/2024 deri më 18/05/2024.

Lista e konkurentëve për të fituar Ofertën për ekskursion të maturantëve të Gjinnazit ”Hajdar Dushi” në Gjakovë, janë :

1. SH.P.K. “Armendi -Tours ”
2. SH.P.K. ”Meti Commerc”
3. SH.P.K. ”Meti –Tours”
4. SH.P.K. “Kushtrimi NMI”

#### Raport i Komisionit selektues:

Hapja e ofertave u bë me dt.22/04/2024 në ora 14:30 sipas ofertës nr.04/1763 i dt.16/04/2024 ku prezent kanë qenë përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit dhe Gjinnazit ”H. Dushi” Gjakovë :

- 1.Gjokë Tahiri – Drejtor i shkollës - Kryesues
- 2.Marjan Ndoja - Kryetar i Këshillit Drejtues të shkollës - Anëtarë
- 3.Flutur Këpuska – zyrtare e DKA - Anëtare

Të gjitha ofertat janë hapur dhe lexuar në praninë e kompanive konkurruese.

**Firma transportuese SHPK “Armendi -Tours”-Gjakovë** ka konkuruar me çmim 137,00 € për Hotelin “FaFa “në Durrës dhe Hotel “Dolce Vita” në Durrës me çmimi 117€ me konfirmim rezervimi nga hoteli në fjalë ku është e përfshirë edhe Menuja në detaje. Në ofertë përfshihen katër (4) fjetje me pansion të plotë që nga 14/05/2024 deri më 18/05/2024 dhe vizitat në qytetet e Republikës së Shqipërisë.

Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.28/02/2022 gjer me dt.27/02/2027. Posedon Çertifikatën e Mjekut për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës SHMLMj ”Hysni Zajmi” në Gjakovë. Janë të përfshirë 6 shoferë e të pajisur me ertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 6 autobusë. Gjithashtu ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit (ARBK ) të firmës dhe kontrollin teknik 6 mujor të autobusëve sipas procedurave ligjore, ka ofruar Referencat me imazh pozitiv, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal, po ashtu ka prezentuar Konfirmim Rezervimi me Hotelin



“Dolce Vita” dhe Hotelin “FAFA” me të cilën sipas Tenderit të shkollës me nr.04/1763 të dt.16.04.2024 është kërkuar sipas pikës 12. të na prezentoni kontratën origjinale në mes të Agjensis turistike dhe hotelit e më cilin dokument ju nuk keni prezentuar por keni prezentuar vetëm rezervim, andaj oferta e juaj REFUZOHET për shkak të pikës 12.

**Firma transportuese SH.P.K. “METI COMERC ”** ka konkuruar me çmim prej 140€ për nxënës. Oferta bazohet në 4 (katër) fjetje me pasion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel “Bonita” në Durrës ndërsa vizita qyteteve të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese. Janë të përfshirë katër (6) shoferë e të pajisur me certifikatë mjekësore dhe janë prezantuar 6 autobusë. Posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.08/03/2021 gjer me dt.07/03/2026, gjithashtu ka prezantuar Çertifikatën e Regjistrimit, dhe Vërtetimin Tatimor i mungon sigurimi i mjekut.

SH.P.K. “Meti Comerc” ka munges të dokumentacionit lidhur me sigurimin e mjekut ku nuk ka të cekur datën si dhe konfirmim rezervimi nga Hotel “Bonita”, **me të cilën sipas Tenderit të shkollës me nr.04/1763 të dt.16.04.2024 është kërkuar sipas pikës 12. të na prezentoni kontratën origjinale në mes të Agjensis turistike dhe hotelit e më cilin dokument ju nuk keni prezentuar por keni prezentuar vetëm rezervim, andaj oferta e juaj REFUZOHET për shkak të pikës 12.**

**Firma transportuese SH.P.K. “METI TOURS”** ka konkuruar me çmim prej 145.00€, për nxënës ku në këtë çmim ka ofruar që kujdestarët e klasave lirohen nga të gjitha obligimet e këtij ekskursioni, kompania merr përsipër bartjen e nxënësve në mbrëmjen e maturës , të gjithë nxënësit janë të liruar nga të gjitha obligimet për shfrytëzimin e plazhit dhe shfrytëzimin e pishinës brenda hotelit. Oferta bazohet në 4 (katër) fjetje me pasion të plotë, ku ju është ofruar qëndrim në Hotel “Royal G” Mali i Robit Durrës prej dt.14/05/2024 deri më 18/05/2024 dhe vizitat në Republikën e Shqipërisë.

Kompania SHPK “Meti Tours” posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.07/06/2019 gjer me dt.06/06/2024, Çertifikatën e Regjistrimit(ARBK) të SH.P.K “Meti Tours”, Vërtetimin Tatimor dhe Komunal, gjithashtu firma ka ofruar referenca me imazh pozitiv, posedon Çertifikatën e Mjekut për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës “Hysni Zajmi” në Gjakovë. Janë të përfshirë 6 shoferë e të pajisur me Çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 6 autobusë. Firma ka ofruar Konfirmim Rezervimi nga Kompleksi “Bonita” **me të cilën sipas Tenderit të shkollës me nr.04/1763 të dt.16.04.2024 është kërkuar sipas pikës 12. të na prezentoni kontratën origjinale në mes të Agjensis turistike dhe hotelit e më cilin dokument ju nuk keni prezentuar por keni prezentuar vetëm rezervim, andaj oferta e juaj REFUZOHET për shkak të pikës 12.**

**Firma transportuese N.P.T. ”Kushtrimi NMI”** ka konkuruar me çmim prej 130.00€, për nxënës gjithashtu ka ofruar nga 2 nxënës pa pagesë dhe kujdestarët e klasës. Vizitat në qytetet të Republikës së Shqipërisë bëhen me marrëveshje në mes të palëve kontraktuese.

Sipas ofertës së prezantuar iu është ofruar qëndrimi në Hotel “Fa Fa Resort” në Durrës, ku edhe ka prezantuar në kopje konfirmim rezervimi e hotelit nga administratori Ymer Lushakaj. Në ofertë përfshihen katër (4) fjetje me pasion të plotë që nga dt.14/05/2024 gjer më dt.18/05/2024.

N.P.T. ”Kushtrimi NMI” posedon Licencën D – për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve me autobus brenda dhe jashtë Kosovës, licencë kjo e vlefshme nga dt.15/04/2021 gjerë më dt.14/04/2026, Çertifikatën e regjistrimit ARBK, Referencat për imazhin e firmës gjithashtu

AE KO  
e Gjak  
ia per Ar



EPUB  
Direktora  
Gjakovë

firma ka marrëveshje – nën kontraktim me firmën SH.P.K.“BICI Com1” Podujevë të cilën e përfaqëson z. Behxhet Bici. Firma “Kushtrimi NMI” posedon Çertifikatën e Mjekut për përkujdesjen e nxënësve (maturantëve) të shkollës “Hysni Zajmi” në Gjakovë. Firma ka ofruar 5 shoferë të pajisur me çertifikatën mjekësore dhe janë prezantuar 5 autobusë.

Firma ka ofruar Konfirmim Rezervimi nga Hotel “Fa Fa Resort “në Durrës me të cilën sipas Tenderit të shkollës me nr.04/1763 të dt.16.04.2024 është kërkuar sipas pikës 12. të na prezentoni kontratën origjinale në mes të Agjensis turistike dhe hotelit e më cilin dokument ju nuk keni prezentuar por keni prezentuar vetëm rezervim, andaj oferta e juaj REFUZOHET për shkak të pikës 12.

### Arsyetim

Pas shqyrtimit të ofertave të ofruara nga firmat konkurreuese, Komisioni vendosi që për shkak të mos plotësimit të dokumentacionit kryesisht sipas pikës 12 të Tenderit të shkollës nr.04/1763 të dt.16.04.2024 me të cilin është kërkuar të prezantohet kontrata origjinale në mes të Agjencisë turistike dhe hotelit e më cilin dokument asnjëri nga ofertuesit nuk keni prezentuar kontratë por keni prezentuar vetëm rezervim (konfirmim), andaj ofertat e juaja REFUZOHEN për shkak të pikës 12.

### Komisioni selektues:

1. Gjokë Tahiri  
(emri dhe mbiemri)
2. Marjan Ndoja  
(emri dhe mbiemri)
3. Flutur Këpuska  
(emri dhe mbiemri)

Kryesues i Komisionit  
(pozita)

dt.23 /04/2024

2. Marjan Ndoja  
(emri dhe mbiemri)

Anëtar  
(pozita)

dt.23/04/2024

3. Flutur Këpuska  
(emri dhe mbiemri)

Anëtare  
(pozita)

dt.23/04/2024



### Procesverbali iu dërgohet:

- Shkolla “Hysni Zajmi” Gjakovë
- Agjencie turistike
- Arkivit